

SHTOJCA

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Objekti i prokurimit

"Blerje stabilizanti për rrugët rurale"

1. QËLLIMI I FURNIZIMIT

Objekti i kësaj procedure prokurimi konsiston në furnizimin me materiale stabilizant për trajtimin dhe stabilizimin e shtresave rrugore ekzistuese të rrugëve rurale në administrim të Bashkisë Peqin.

Produkti do të përdoret për rehabilitimin dhe përmirësimin e parametrave teknikë të shtresave rrugore ekzistuese, me qëllim rritjen e kapacitetit mbajtës, uljen e deformimeve, reduktimin e pluhurit, përmirësimin e rezistencës ndaj ujit dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së rrugëve rurale.

Furnizimi përfshin jo vetëm sigurimin e produktit, por edhe transportin dhe dorëzimin e tij në vendet që do të përcaktohen nga Autoriteti Kontraktor gjatë zbatimit të kontratës

2. KËRKESAT E PËRGJITHSHME

Produkti i ofertuar duhet të jetë:

- Produkt profesional për stabilizimin e rrugëve.
- Produkt i ri dhe i papërdorur.
- Me cilësi të garantuar nga prodhuesi.
- I përshtatshëm për stabilizimin e rrugëve rurale me shtresa granulare ekzistuese.
- I prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë.
- I sigurt për transport, magazinim dhe përdorim.
- Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe europian për mbrojtjen e mjedisit.

3. KARAKTERISTIKAT TEKNIKE MINIMALE

Stabilizanti duhet të plotësojë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

3.1 Të jetë produkt profesional për stabilizimin e shtresave rrugore.

3.2 Të përmirësojë vetitë mekanike të materialeve ekzistuese të rrugës.

3.3 Të rrisë kapacitetin mbajtës të shtresës rrugore.

3.4 Të përmirësojë lidhjen ndërmjet grimcave të materialit.

- 3.5** Të reduktojë depërtimin e ujit në shtresën rrugore.
 - 3.6** Të përmirësojë rezistencën ndaj cikleve lagështi–thatësi.
 - 3.7** Të zvogëlojë deformimet plastike.
 - 3.8** Të reduktojë ndjeshëm formimin e pluhurit.
 - 3.9** Të rrisë qëndrueshmërinë ndaj trafikut.
 - 3.10** Të reduktojë nevojën për mirëmbajtje periodike.
 - 3.11** Të jetë kompatibël me materialet granulare natyrore që përdoren në rrugët rurale.
 - 3.12** Të mos ndikojë negativisht në mjedis dhe ujërat sipërfaqësore.
 - 3.13** Të mos jetë produkt toksik për përdoruesit gjatë aplikimit sipas udhëzimeve të prodhuesit.
 - 3.14** Të ruajë karakteristikat e tij fiziko-kimike gjatë transportit dhe magazinimit.
-

4. DOKUMENTACIONI TEKNIK

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Skedën teknike (Technical Data Sheet).
- Fletën e të Dhënave të Sigurisë (Safety Data Sheet – SDS).
- Deklaratën e konformitetit ose dokument ekuivalent.
- Certifikatat e cilësisë të prodhuesit (kur disponohen).
- Raportet laboratorike të testimit ose dokumentacion ekuivalent që provon karakteristikat teknike të produktit.
- Autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.
- Udhëzimin teknik për dozimin dhe aplikimin e produktit.

5. STANDARDET

Produkti duhet të jetë i prodhuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë.

Në rast se disponohen, do të paraqiten certifikata sipas standardeve:

- ISO 9001 ose ekuivalente;
- ISO 14001 ose ekuivalente;
- ISO 45001 ose ekuivalente;

ose standarde të tjera ndërkombëtare të zbatueshme për produktin.

Paraqitja e standardeve ekuivalente do të konsiderohet e pranueshme.

6. KËRKESAT PËR TRANSPORTIN

Operatori ekonomik fitues merr përsipër:

- ngarkimin e produktit;
- transportin;
- shkarkimin;
- dorëzimin në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor.

Transporti do të kryhet me mjetet e operatorit ekonomik. Të gjitha shpenzimet konsiderohen të përfshira në çmimin e ofertës. Autoriteti Kontraktor nuk do të kryejë pagesa shtesë për transportin. Transporti duhet të realizohet në mënyrë që të ruhet cilësia e produktit gjatë gjithë procesit.

7. MËNYRA E FURNIZIMIT

Furnizimi do të realizohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Dorëzimi mund të kryhet në një ose disa faza. Operatori ekonomik është i detyruar të realizojë çdo furnizim brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Materiali do të dorëzohet në rrugët rurale të përcaktuara nga Bashkia Peqin. Në çdo rast operatori ekonomik do të njoftohet paraprakisht për vendin e dorëzimit.

8. PAKETIMI

Produkti duhet të dorëzohet në paketimin origjinal të prodhuesit. Paketimi duhet të jetë i paprekur. Duhet të përmbajë minimalisht:

- emrin e produktit;
- emrin e prodhuesit;
- numrin e lotit;
- datën e prodhimit;
- afatin e përdorimit (kur aplikohet);
- mënyrën e ruajtjes.

9. RUAJTJA

Produkti duhet të ruhet sipas rekomandimeve të prodhuesit. Operatori ekonomik është përgjegjës për ruajtjen e cilësisë deri në momentin e dorëzimit.

10. MARRJA NË DORËZIM

Malli do të konsiderohet i pranuar vetëm pasi:

- të jetë dorëzuar në vendin e kërkuar;
- të jetë kontrolluar nga komisioni i marrjes në dorëzim;
- të jetë konstatuar përputhshmëria me specifikimet teknike;
- të jetë nënshkruar procesverbali i marrjes në dorëzim.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë verifikime teknike ose analiza laboratorike, nëse e çmon të nevojshme.

Në rast se produkti nuk përmbush parametrat teknikë të kërkuar, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të refuzojë marrjen në dorëzim dhe të kërkojë zëvendësimin e tij me shpenzimet e operatorit ekonomik.

11. GARANCIA E CILËSISË

Operatori ekonomik garanton se:

- produkti është i ri;
- produkti është i papërdorur;
- produkti është në përputhje me dokumentacionin teknik të prodhuesit;
- produkti plotëson të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara.

Çdo mospërputhje me specifikimet teknike do të përbëjë shkak për refuzimin e produktit.

12. KËRKESA TË TJERA

Operatori ekonomik duhet të sigurojë asistencë teknike për mënyrën e përdorimit të produktit, nëse kjo kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Në rast nevojë, operatori ekonomik duhet të ofrojë udhëzime për dozimin, përzierjen dhe aplikimin e stabilizantit, sipas rekomandimeve të prodhuesit.

Produkti duhet të jetë i përshtatshëm për kushtet klimatike të Republikës së Shqipërisë dhe për përdorim në rrugë rurale me trafik të lehtë dhe mesatar.

Punoi :

Ing.Anita DEHIMA